



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.743/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Adnan Konushevcu kryesues, Afijete Sada - Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Nikoll Perkaj nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.743/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Nikoll Perkaj nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Nisma Socialdemokrate, në Qendrat e Votimit: QV 0201c Gjinnazi "Hajdar Dushi" Objekti i Ri, QV 0202x Shkolla Fillore ""Yll Morina" e re, QV 0204c Shkolla e Mesme "Kadri Kusari", QV 0207c Cërmjan Shkolla Fillore "Ali Hasi", QV 0211c Korenicë Shkolla Fillore "Luigj Gurakuqi", QV 0222c Brekoc Shkolla Fillore "Zef Lush Marku" dhe QV 0224c Dobilibare Shkolla Fillore "Dëshmorët Lleshi".

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Gjakovës Nikoll Perkaj nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar fletëvotimet në Qendrat e Votimit: QV 0216c Novosellë e Ulët Shkolla Fillore "Engjëll Gjoni", QV 0215c Bec Shkolla Fillore "Ahmet

Rrustemi", QV 0205c Gjakovë Shkolla Fillore "Zekeria Rexha" dhe QV 0202c Gjakovë Shkolla Fillore "Mustafa Bakija" e vjetër.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për kuvend komunal Nikoll Perkaç nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Gjakovës, në të cilën pretendon se ka fakte të pamohueshme se votat e tij dhe kandidatit tjetër nga Subjekti Nisma Social Demokrate Gjok Sokoli, janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi dhe atë në Qendra e Voteve: 0215c, 0216c, 0202x, 0224c, 0205c, 0207c, 0201c, 0222c, 0202c, 0202x, 0224c, 0205c, 0207c dhe 0211c në komunën e Gjakovës. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e 20 dëshmitarëve.

PZAP, me datë 04.11.2021, i ka dërguar kërkesë për përgjigje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me të cilën ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 04.11.2021, ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.11.2021, të KQZ-së theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, nuk lejon asnjë formular të rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e kandidatëve që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatë nuk kanë vota formulari procedohet si i rregullt dhe shkon në auditim. Ndër të tjera është theksuar se auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të gjeturave përgatit raportin dhe QNR në bazë të raportit të auditimit i rekomandohet KQZ-së që vendotimet që kanë probleme të kësaj natyre të rinumërohen. Andaj asnjë formular që nuk ka përputhje nuk mund të procedohet si i rregullt dhe i njëjti i nënshtrohet auditimit kështu që vendotimi në fjalë është verifikuar dhe i njëjti nuk është rekomanduar nga QNR-ja.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për Kuvend Komunal Nikoll Perkaç nga Subjekti Politik Nisma Socialdemokrate, me seli në Gjakovë, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në qendrat e votimit 0215c, 0216c, 0202x,

0224c, 0205c, 0207c, 0201c, 0222c, 0202c, 0202x, 0224c, 0205c, 0207c dhe 0211c në komunën e Gjakovës, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, te vendosura si ne pikën -II- te dispozitivit te këtij vendimi, nga se rezulton se ne Formularin e Rezultateve të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për kuvend komunal Nikoll Prekaj, nuk e ka asnjë votë, ndërsa sipas deklaratave të votueseve të bashkangjitura në apel e që ndërlidhen me këto QV, deklarojnë se kanë votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratata e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencia, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës se lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimim e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, te dispozitivit paneli, vlerëson se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi te qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për QV-të e vendosura në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato QV, poashtu për paneli është e qartë se në këto QV kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me

asnjë provë shkresore ankuesi në QV e vendosur në pikën IV të dispozitivit nuk i'ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, prandaj u vendos si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.743/2021 më datën 05.11.2021

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.